



BACHELOR NË “FINANCË”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Diploma Bachelor në Financë e ofruar nga Universiteti European i Tiranës synon t'u sigurojë studentëve një kuptim të plotë të parimeve dhe praktikave financiare. Objektivat kryesore të këtij programi studimi përfshijnë: sigurimin e studentëve me një bazë solide në teoritë financiare, me aftësi analitike, mësimin e studentëve se si të identifikojnë, masin dhe menaxhojnë rreziqet financiare, përgatitjen për certifikime profesionale, si për shembull Chartered Financial Analyst (CFA), ACCA, Auditues Ligjor ose certifikime të tjera të ngjashme.

REZULTATET E TË NXËNIT

Programi Bachelor në “Financë” është hartuar duke ndërthurur përvojën praktike me orientimin akademik, duke përgatitur ekonomistë të aftë dhe kompetent. Studentët e diplomuar në BA Financë janë në gjendje të:

- demonstrojnë aftësi analitike dhe të të menduarit kritik.
- trajtojnë çështjet ekonomike, duke përdorur njohuritë dhe mjetet e nevojshme financiare për të vlerësuar aktivet reale dhe financiare, për të analizuar performancën financiare të një kompanie dhe për të identifikuar faktorët e rrezikut.
- përdorin metodat dhe mjetet bazë matematiko-statistikore, nëpërmjet mbledhjes së informacionit, modelimit të të dhënave dhe interpretimit të raporteve statistikore për të analizuar çështjet ekonomike dhe financiare për të gjykuar në mënyrë autonome.
- demonstrojnë njohuri dhe kuptim të parimeve themelore të teorisë ekonomike përmes kurseve si hyrje në ekonomi, Mikroekonomi, Makroekonomi, Histori e Doktrina Ekonomike.
- interpretojnë dhe vlerësojnë dukuritë dhe dinamikat e sistemit ekonomik.
- vlerësojnë sistemin e përgjithshëm ekonomik si dhe efektivitetin e politikave publike dhe ndikimin e tyre në tregje.
- të vlerësojnë sistemin e përgjithshëm financiar dhe të jenë në gjendje të analizojnë tendencat e pritshme të normave të interesit dhe kursit të këmbimit, të formulojnë analiza të portofolit dhe vlerësime të vendimeve të financimit.

PROFILI: BANKË

Programi synon të përgatisë ekonomistë të specializuar në çështjet financiare dhe bankare. Të diplomuarit në Bachelor në Financë, me profil Bankë, janë në gjendje të:

- interpretojnë dhe vlerësojnë rolin e institucioneve financiare dhe sjelljen e tyre brenda sistemit ekonomik;



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- përshkruajnë dhe shpjegojnë konceptet në lidhje me menaxhimin e rrezikut në sektorin bankar;
- të kuptojnë funksionimin e tregjeve financiare dhe rolin e ndërmjetësve financiarë.

PROFILI: KONTABILITET

Programi synon të përgatisë ekonomistë të specializuar në fushën financiare dhe kontabilitet. Të diplomuarit në Bachelor në Financë, me profilin e Kontabilitetit janë në gjendje të:

- lexojnë dhe analizojnë pasqyrat financiare;
- shpjegojnë dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit;
- regjistrojnë, organizojnë dhe përmbledhin të dhënat financiare si dhe të përgatisin pasqyrat financiare;

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

1. Specialist Banke (specialist bankingu qendror, analist kredie, specialist pagesash, specialist thesari, specialist në menaxhimin e kredive, specialist për rrezikun dhe përputhshmërinë, specialist për shërbime klientele, arkëtar),
2. Specialist sigurimesh (specialist shitjesh (jeta, jojeta), specialist rreziku, specialist dëmsh, specialist rrjeti),
3. Specialist sigurimesh shoqërore & shëndetësore,
4. Specialist në sektorin/financa publike (buxhetim, taksim, punonjës në thesar),
5. Ekspert tatimor,
6. Këshilltar tatimor,
7. Financier për financat private,
8. Financier ndërmarrjesh/biznesi,
9. Analist/Vlerësues financiar,
10. Kontabilist,
11. Ekspert tregjesh financiare,
12. Ndërmjetës financiar për Investimin në Letra me Vlerë,
13. Konsulent Investimesh,
14. Specialist/Menaxher projektsh,
15. Ekspert në menaxhim dhe gjenerim fondesh,
16. Auditues të brendshëm/jashtëm,
17. Studiues i shkencave ekonomike,
18. Specialist marketing dhe marketing digjital,
19. Specialist i tregtisë elektronike,
20. Specialist burimesh njerëzore,
21. Lektor i fushës së ekonomisë.

BACHELOR "FINANCË" 180 ECTS

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|-----|------|-----|---------------|------|
|-----|------|-----|---------------|------|

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/36 ECTS

| | | | | |
|---|----|---|------------------------------------|-----------|
| 1 | I | 1 | Matematikë 1 | 6 |
| 2 | I | 2 | Matematikë 2 | 6 |
| 3 | I | 2 | Hyrje në sociologji | 6 |
| 4 | I | 1 | Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi | 8 |
| 5 | II | 1 | Teori e Statistikës | 6 |
| 6 | II | 2 | Statistikë e aplikuar | 4 |
| | | | | 36 |

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/94 ECTS

| | | | | |
|----|-----|---|------------------------------|-----------|
| 1 | I | 1 | Mikroekonomi | 6 |
| 2 | I | 2 | Makroekonomi | 6 |
| 3 | I | 1 | Parimet e kontabilitetit | 8 |
| 4 | I | 2 | Kontabiliteti i kostos | 6 |
| 5 | I | 2 | Hyrje në Financë | 6 |
| 6 | II | 2 | Financat publike | 10 |
| 7 | III | 1 | Hyrje në doktrinat ekonomike | 6 |
| 8 | II | 1 | Paraja dhe bankat | 6 |
| 9 | II | 2 | Tregjet financiare | 6 |
| 10 | II | 2 | Hyrje në analizë financiare | 6 |
| 11 | II | 1 | Hyrje në menaxhim | 8 |
| 12 | III | 1 | Financat e ndërmarrjeve | 8 |
| 13 | II | 1 | Bazat e marketingut | 6 |
| 14 | III | 2 | Investime | 6 |
| | | | | 94 |

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/ 24 ECTS

| PROFILI I | | BANKË | | |
|------------|--------|--------------|--|-----------|
| 1 | III | 2 | Ekonomi dhe teknikë bankare | 6 |
| 2 | II | 2 | Hyrje në menaxhim risku | 6 |
| 3 | III | 1 | E drejtë tregtare | 6 |
| 4 | III | 1 | Standardet e kontabilitetit (SKK+SNK) | 6 |
| 5 | II/III | 1-2 | Honor's course | 6 |
| PROFILI II | | KONTABILITET | | |
| 1 | III | 2 | Sistemet e kompjuterizuara në Kontabilitet | 6 |
| 2 | II | 2 | Kontabilitet financiar | 6 |
| 3 | III | 1 | Standardet e kontabilitetit (SKK+SNK) | 6 |
| 4 | III | 1 | Parimet e auditimit | 6 |
| 5 | II/III | 1-2 | Honor's course | 6 |
| | | | | 24 |

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/20-22 ECTS

| | | | | |
|---|-----|---|------------------------------------|-----------|
| 1 | II | 1 | Anglisht | 5 |
| 2 | I | 1 | Bazat e informatikës | 4 |
| 3 | III | 2 | Hartim dhe menaxhim projektsh | 6 |
| 4 | III | 2 | Sipërmarrja dhe menaxhimi i SME-ve | 8 |
| 5 | III | 2 | Praktikë & zhvillim studenti | 5 |
| | | | | 20 |

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

| | | | | |
|---|-----|---|---|---|
| 1 | III | 2 | Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm përfundimtar | 7 |
|---|-----|---|---|---|

TOTAL 181